

ARTI PAS DEMOKRATIZMIT PEDAGOGJIA E SAMITIT TË RI BOTËROR

Jonas Stal

Kristina Agilera takon dinosaurët:

Tortura në masë e demokracisë liberale

Në 2007-n, filozofi Vinsent van Herven Uj dhe unë ndeshëm një dosje të klasifikuar që dokumentonte një interrogim në burgun e Guantanamo në Kubë, e cila ishte shpërndarë përmes website-it të *Time Magazine*. Kabllogrami përmbante një raport të detajuar të interrogimit përgjatë tre muajve të Mohamed Mani Ahmed Al-Katani, që presupozohej të ishte rrëmbyesi i 20-të i sulmeve mbi Kullat Binjake dhe Pentagonin në 2001-shin.

Në veçanti raporti na tërhoqi vëmendjen për shkak të natyrës së teknikave të tortures që ishin përdorur. Përveç metodës së tmerrshme të tortures të quajtur *water boarding*, na la përshtypje përdorimi i kulturës pop si një mjet për të “torturuar” të burgosurin. Rojet e çorientonin thellësisht Al-Katanin duke e lëvizur nëpër vende të ndryshme të errëta, gjë që e bënte të pamundur për të të rrokte kohën ose drejtimin në të cilin ai, si një mysliman, duhej të drejtonte lutjet e tij. Më pas, ata i çrregulluan edhe gjumin, duke bërë që ndjesia e përgjithme e çorientimit që ai kishte të thellohej akoma më tepër. E gjithë kjo ngriti skenën teatrale në të cilën Al-Katanin iu nënshtrua një ikonografie komplekse të kulturës bashkëkohore. Për shembull, ai iu nënshtrua dëgjimit të muzikës së zhurmët, si këngë nga Metallica, Eminem, dhe këngës “Dirrty” të Kristina Agileras.

Më tej Al-Katani iu nënshtrua edhe imazheve të vajzave *pin-up*, ushqimit johallall të Burger King, dhe dritave stroboskopike. Të gjitha këto janë simbole të çlirimit perëndimor, që në kontekstin e Guantanamo marrin dimensione mjaft shtypëse. Ose më saktë, në këtë kontekst, dimensionet jashtëzakonisht shtypëse që janë ndërkaq të prishme në këto simbole dalin në pah në mënyrë të padurueshme.

Kulmi tragjik i ditarit të interrogimit është momenti i parë në të cilin rojet i japin Al-Katanit një moment pushimi. Në 10 janar 2003, në orën 22:45, thuhet se: “Interroguesi i dha leje të burgosurit të zgjidhte një temë bisedimi.” Dhe në atë moment, nga




kjo infrastrukturë e errët e gjendjes së jashtëzakonshme, ditari përmend se “*I burgosuri donte të fliste për dinosaurët.*”

Se pse, asgje gjatë interrogimit nuk më duket më tragjike se kjo. Rikumbimi i kësaj pyetje në këtë botë simbolesh të rreme të çlirimit: Kristina Agilera, Burger King, *Playboy Magazine*, të përziera bashkë në një vorbull shokuese dhe të dhunshme. Dhe prej këtij realiteti brutal, lind një pyetje e vetme, që përpiqet ta rivendosë të tashmen katastrofike të Al-Katanit duke iu drejtuar *prehistorisë*. Një bisedim mbi dinosaurët si një ilaç ndaj hamburgerave dhe yjeve pop-porno; figura e diplodokusit monumental si pishtari i fundit i paprekur nga këto simbole të rreme të çlirimit. Al-Katani duket sikur po përpiqet të arrijë një pikë sa më jashtë rendit simbolik shtypës të Guantanamos që është e mundur.

Megjithatë, është roja ai që është përgjegjës për historinë e dinosaurëve, dhe përgjigjia e tij është regjistruar si më poshtë:

Interroguesi paraqiti historinë e dinosaurëve dhe foli për meteorën që i shfarrosi

ata, dhe e barazoi këtë ngjarje me luftën bërthamore, i burgosuri shpreh injorancë të thellë për dinosaurët dhe kozmosin, tema që trajtohen në shkollat fillore në SHBA.¹



Konstatimin e fundit mund ta kundërshtojmë fare thjesht duke iu referuar provimit të këtij nxënësi të klasës së katërt, ku përgjigjia se dinosaurët u krijuan nga Zoti në ditën e gjashtë meriton një *smiley sticker*. Interrogimi në Guantanamo merr formën a një “provimi” të ngjashëm, që i kërkon Al-Katanit t’i nënshtrohet tregimit të historisë nga roja si në vijim: Dinosaurët u kërcënuan prej një meteori të ngjashëm me kërcënimin për të hapur luftë bërthamore

kundër Shteteve të Bashkuara nga Sadami dhe Bin-Ladeni: *e vërtetë apo jo?*...

Falë kablogrameve të interrogimeve në Guantamo na jepet mundësia të arrijmë tek një kuptim turbullues i kulturës tonë. Pasi ajo çka Al-Katani detyrohet ta përjetojë si një formë të skajshme torture mendore, përbën për ne dekorin e përditshëm të jetëve tona urbane: kudo që kthejmë vështrimin, simbolizmi i shkatërrimit na rrethon në jetët tona të përditshme. Vetëm se ne i përjetojmë tingujt, imazhet, dhe konsumin tonë të përgjithshëm të këtyre akteve si çlirim. Al-Katani na bën të ndjeshëm edhe një herë *ndaj torturës intelektuale në masë që ne përjetojmë në trajtën e demokracisë liberale.*



Lenin në Japoninë:

Zbulimi i demokracisë themelore

Paradoksi i industrisë krijuese që na rrethon është se ajo konsiston në simbole që ne jemi mësuar t'i identifikojmë si exemplarë të lirisë. Ushqimi i lirë i përpunuar. Muzika pop. Vajzat *pin-up*. Këto janë simptomat problematike të asaj që ka qenë edhe një lëvizje emnicipuese e mirëfilltë. Ndërsa artistët angazhoheshin në deshifrimin dhe kundërshtimin e këtyre simboleve të rremë, ne përballemi me një operacion të ndërlikuar. Nga njëra anë, duhet të njohim atë që na kanë dhënë bazat emancipuese të revolucionit seksual, industrial, e kështu me rradhë. Nga ana tjetër, duhet të shkëputemi prej simboleve të kaluara të çlirimit që funksionojnë sot brenda procesit të torturës intelektuale në masë të demokracisë liberale, thelbin e të cilës e gjejmë në interrogimin në Guantanamo. Në mënyre perverse, kuptimi emancipues i demokracisë dhe kuptimi shtypës i demokracisë janë të ndërlidhur, duke rezultuar në një situatë në të cilën është e vështirë të ndash torturën intelektuale prej emancipimit çlirues.

Kështu pra, na nevojitet një gjuhë që na lejon të bëjmë dallimin midis gjuhës së emancipimit dhe gjuhës së shtypjes. Ndonëse "demokracia" është një fjalë e vetme, do të mund të vërenim se në lëvizjen e *Indignados* në Spanjë dhe në Luftën Kundër Terrorizmit me burgjet e saj jashtëterritoriale, ku të dyja legjitimizohen përmes fjalës "demokraci," kjo fjalë përdoret për të legjitimizuar dy procese krejt të ndryshme.

Kur Lenini vizitoi Japoninë, ai u detyrua të kryente një ndërhyrje që sot ne do ta njihnim si propozimin dëlëzian për të "folur mbi atë që ne njohim më mirë në gjuhën që ne njohim më pak." Japonishtja e Leninit ishte po aq e mirë sa shqipja ime sot, dhe kur i drejtohej masave ai ishte i detyruar të përdorte një përkthyes. Kur arriti tek kritika e tij themelore e asaj që ai e quante "demokracia borgjeze," përkthyesi e pa në një mënyrë konfuze. Lenini e kuptoi se në japonisht fjala "demokraci" nuk ekzistonte, dhe se në rastin më të mirë ajo mund të përkthehej si një *izëm*: si *demokratizëm*.

Në këtë rast përkthimi rezultoi në subversion. Termi demokraci u thye, u bë copë çika, dhe u *dyzua*. Duke folur gjuhën më pak të njohur për të Lenini u përball me një zgjedhje: atë midis demokratizmit dhe demokracisë. Në japonisht, demokraci ishte fja-



la që duhej ende të *flitej*. Për Leninin, ashtu si për ne sot, demokracia ishte një term që duhej ende të *imagjinohej në praktikë*.

Lenini e shfrytëzoi mirë këtë term, dhe pasi u kthye në Rusi rrjeshtat vijues mund të gjenden në sprovën e tij “Klasa punëtore dhe demokracia borgjeze”:

Përveç interesave të një sektori të madh të pronarëve të tokave, demokratizmi borgjez rus pasqyron interesat e masës së tregëtarëve dhe prodhuesve të manufakturës, kryesisht të mesëm dhe të vegjël, si dhe (dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme) ato të masës së pronarëve dhe pronarëve të vegjël mes fshatarësisë.²

Sot, koncepti i demokratizmit është pikërisht ajo që filozofi Alen Badiu [*Alain Badiou*] quan “demokracia kapitaliste.” Dhe simbolet e çliuara të kulturës pop që prodhohen prej industrisë krijuese duhet të konsiderohen arti i saj dhe armët e saj të parapëlqyera të torturës intelektuale në masë.

Detyra jonë, si artistë politik, është ta çlirojmë demokracinë prej demokratizmit. Të riimagjinojmë një përkthim po aq rrënjësor sa ai që japonishtja i propozoi Leninin. Një pedagogji radikale në mbrojtje të një demokracie themeltare që do t’i kundërvihet katastrofës demokratiste që na ka rënë përsipër.

Për ta bërë këtë, na duhet një art pas demokratizmit.

Arti pas demokratizmit:

Pegagogjia e Samitit të Ri Botëror

Besoj se veprimi i parë i nevojshëm për të çliuar artin prej industrisë së kulturës të demokratizmit që po e mban peng, është riartikulimi i një konteksti politik në të cilin ne duam që arti të veprojë. Ky proces riartikulimi nuk është vetëm ligjërues, ai do të duhet gjithashtu të ndodhë *përmes praktikës së artit*. Arti në mbrojtje të demokracisë themeltare nënkupton se ne kërkojmë që arti të përqafojë projektin e politikave progresive dhe emancipuese, por edhe se arti do të duhet, edhe një herë, t’i jap formë këtij projekti. Pasi arti progresiv nuk është thjesht një produkt i politikës, ai është gjithashtu një *forcë politike në vetvete*.

Kjo është arsyeja pse gjatë viteve të fundit unë kam punuar me parti politike, organizata politike joparlamentare dhe lëvizje sociale: të gjitha të fokusuar mbi shqyrtimin e



Jonas Stal, Samiti i Ri Botëror – Berlin (2012). Fotografi nga Lidia Rosneri.

rolit që arti do të luante kur e vendosim atë në një sferë tjetër politike, por edhe se *si kjo sferë politike ndryshon kur artistët angazhohen në të.*

Më lejoni të prezantoj një rast studimor nga praktika ime, organizata ime artistike dhe politike e quajtur “Samiti i Ri Botëror.” Gjatë vitit të fundit organizata jonë ka zhvilluar një seri “parlamentesh alternativë” në të gjithë botën për përfaqësues politik dhe juridik të organizatave që për momentin janë të listuara në listat ndërkombëtare të terrorizmit.

“Lista e terroristëve” përfshin organizata që konsiderohen ndërkombëtarisht kërcënime ndaj shtetit. Në Bashkimin Evropian, një komitet sekret, e ashtuquajtura *Clearing House*, bën listën e terroristëve për BE-në. *Clearing House* mblidhet dy herë në vit, në fshehtësi dhe nuk ekzistojnë procesverbalë të mënyrës se si merren vendimet për përzgjedhjen e organizatave politike. Dikush mund të thoshte me plotë të drejtë se sipas vetë standardeve të tij, komiteti që është përgjegjës për vendosjen e organizatave të ndryshme “jashtë” demokratizmit, është i organizuar në një mënyrë në thelb jodemokratike.³ Pasojat për organizatat e listuar dhe njerëzit që kanë kontakt me to përfshin bllokimin e të gjithë llogarive bankare dhe ndalimin ndërkombëtar të aftësisë për të udhëtuar.

Si Samiti i Ri Botëror ne përpiqemi të shqyrtojmë se në çfarë niveli arti mund të funksionojë si një mjet për të anashkaluar këto ligje kundërterroriste. Nga njëra anë, ne përpiqemi t’iu shmangemi këtyre ligjeve duke funksionuar si një *parlament endacak*: Samiti i Ri Botëror nuk ka një vendndodhje fikse gjeografike; nuk përfaqëson asnjë shtet, asnjë pronë, apo pretendim të pakufizuar mbi të drejtën e fjalës. Nga ana tjetër, ne shfrytëzojmë në maksimum statusin e jashtëzakonshëm juridik të artit: faktin se arti, deri edhe në nivel kushtetues, nuk është thjesht i pranishëm, se *ai gjithmonë njëkohësisht vë në pikëpyetje kushtet e kësaj pranie*. Kjo *paqartësi radikale* krijon hapësirën ku ne be-sojmë se premtimi i një politike progresive do të marrë formë.

Me fjalë të tjera, në momentin kur politika jonë falimenton, kur deficieti demokratik shfaqet më hapur se kurrë, ne artistët duhet të marrim situatën në dorë. Kjo do të thotë











Jonas Stal, Samiti i Ri Botëror – Leidë (2012). Fotografi nga Erni Bëtsi

se ne mendojmë se arti është “më politik se sa vetë politika.” Nga fusha e artit, do të duhet të marr formë projekti për një politikë të re progresive. Ky është projekti të cilit ne i jemi dedikuar.

Epizodi i parë i Samitit të Ri Botëror u zhvillua në 4 dhe 5 maj të vitit të kaluar në Sophiensaele, një teatër dhe platformë politike në Berlin. U dërguan rreth njëqind ftesa organizatave të përmendura në listat ndërkombëtare të terrorizmit. Prej atyre që u përgjigjën, ne patëm mundësinë të mirëprisnim katër përfaqësues politikë dhe tre përfaqësues juridikë, avokatët e këtyre organizatave. Më poshtë do t’ju prezantoj përfaqësuesit politikë të pranishëm.

Luis Jalandoni foli në emër të Partisë Komuniste të Filipineve dhe krahut të saj të armatosur Armata e Re e Popullit, një nga grupet e fundit kryengritëse maoiste që ka disa mijra forca të armatosura të vendosura sot në ishujt filipine – një organizatë që fitoi famë duke legalizuar martesat gej, shumë më parë nga ç’ ishte e gatshme ta bënte këtë qeveria e Filipineve, duke e treguar veten, mbi këtë pikë, “më demokratike se sa vetë demokracia.” Projekti i një barazie radikale midis klasave dhe gjinive rezultoi në këtë mënyrë në përfundimin se të gjitha shkëmbimet në fushën e dashurisë duhet të jenë po aq të barabarta.

Musa Ag Asarid foli në emër të Lëvizjes Kombëtare Çlirimtare të Azawadit, një grup kryengritësish i drejtuar prej tuaregëve në Mali që kërkonte pavarësi për dy të tretat e vendit, duke e shpallur atë si shtetin e pavarur të Azawadit. Ata e arritën këtë me armë të vjedhura prej Gadafit dhe i përdorën këto në luftën e tyre për një shtet laik multi-etnik dhe -fetar. Sot ata e gjejnë veten të marginalizuar pasi elementët islamik brenda organizatës morën nën kontroll Azawad, duke çuar në ndërhyrjen franceze në Mali.

Jon Andoni Lekue foli në emër të lëvizjes baske për pavarësi, dhe kuptimi i tij i nocionit të “Baskut” si përfaqësues i të gjithë njerëzve të shtypur në botë – një kategori “nënshitetësie” që nuk kufizohet më nga nocionet e etnicitetit apo të kufijëve territorial.

Fadile Yëldërëm foli në emër të Lëvizjes Kurde të Grave, që punon njëkohësisht kundër Shtetit turk si dhe kundër sundimit të meshkujve brenda lëvizjes revolucionare



Jonas Stal, Samiti i Ri Botëror – Kochi (2013).

kurde. Si një korigjim i historisë së shtypjes dhe skllavërimit të femrave prej meshkujve, që Yëldërëm beson përbën bazat patriarkale mbi të cilat ndërtohet si partia ashtu edhe shteti, ajo propozon një lexim feminist radikal të historisë për të *çliruar demokracinë nga shteti*.

Ky propozim është arsyeja kryesore pse unë vendosa që Samiti i Ri Botëror të jetë një organizatë e mirëfilltë artistike dhe politike, dhe jo një projekt artistik me afat skandence. Propozimi i saj duket paradoksal, pasi a nuk është koncepti bashkëkohor i demokracisë i lidhur historikisht me konceptin e qytet-shtetit të Athinës së lashtë? Mbi këtë pikë një qasje ndërmjet Marksit do të mund të na ndihmonte. Siç nuk lodhet duke përsëritur marksisti Teri Igëlton [*Terry Eagleton*], Marksi ishte një besimtar i madh në arritjet e kapitalizmit, por besonte se socializmi do të ishte i nevojshëm për të zgjidhur kundërshtimet e tij të brendshme kur të vinte puna për të garantuar hyrje të barabartë të produkteve të këtyre arritjeve. Me fjalë të tjera, kapitalizmi nuk është në gjendje të zgjidhë dinamikën e tij të brendshme të shtypjes dhe shfrytëzimit që mbështesin një klasë të privilegjuar gjatë gëzimit të benefiteve të tij – socializmi, sipas Marksit dhe Igëltonit, është emri i ndërhyrjes radikale që nevojitet për të minuar këtë logjikë. Nëse ndjekim propozimin e Yëldërëmit ballafaqohemi me nevojën për një qasje të ngjashme dialektike: historikisht nocioni i demokracisë është mundësuar nga shteti, por për të formuar parimet e saj themelore të barazisë – shpërndarja e barabartë e pushtetit dhe dijes – ne duhet të *asgjësojmë nocionin ekzistues të shtetit* për t'i ndjekur këto parime deri në pasojat e tyre të fundit.

Parimet udhëzuese të Samitit të Ri Botëror nuk erdhën prej sferës artistike në kupimin e ngushtë të fjalës, por u mundësuan falë krijimit të një hapësire nga bota e artit që ndikohej prej forcave të politikës joparlamentare. Ne e kemi vazhduar atë përpjekje gjatë epizodit të dytë të Samitit të Ri Botëror në Leidë, duke mirëpritur Profesorin Jose Maria Sison, themeluesi i Partisë Komuniste të Filipineve dhe Ushtrisë së Re të Popullit, si referues kryesor, si dhe gjatë epizodit të tretë të Samitit të Ri Botëror në Kochi të Indisë. Për momentin jemi duke përgatitur epizodin e katërt në Bruksel si dhe tre

seancat e para të Akademisë së Re Botërore, ku artistët dhe studentët bashkëpunojnë me organizata të lidhura me Samitin e Ri Botëror për të eksploruar rolin e artit sot në fushën e luftës politike.

Koncepte si emancipimi, barazia, dhe demokracia, janë shndërruar në një peshë të vdekur brenda ligjëratës demokratiste që sundon sot – që karakterizohet nga lufta në masë e brumbujve [*drones*], dhe fjalët e lodhura të kryetarëve të opozitës, pengje të idesë se politika sot nuk është asgjë veçse zgjedhja e të keqes më të vogël. *Nuk iu duhet besuar atyre trashëgimia e politikës emancipuese.*

Unë propozoj një pedagogji të një demokracie themeltare si kundërpërgjigje, qëllimi i së cilës është të tregojë se si mund të çlirojmë demokracinë nga shteti. Mjeti revolucionar i quajtur “art” do të jetë arma që do ta sjellë këtë pedagogji në jetë dhe që do të luftojë me pasion përfaqësuesit e demokratizmit.

Dhe në tërë këtë, unë shpresoj se Samiti i Ri Botëror do të mund të jetë kontributi im modest.

Shënime

- 1 Vincent van Gerven Oei dhe Jonas Staal, *us Army Torture Devices* (Amsterdam: Gallery Masters, 2008), 45.
- 2 Vladimir Lenin, “Working-Class and Bourgeois Democracy,” in *Collected Works*, Vol. 8 (Moscow: Foreign Languages Publishing House, 1962), 72–82.
- 3 “Adding Hezbollah to the EU Terrorist List,” Hearing before the Subcommittee on Europe of the Committee on Foreign Affairs House of Representatives (20 qershor 2007).